

Formular për SYLLABUS të lëndës: Letërsi popullore

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|----------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Njësia akademike: | Universiteti i Gjakovës, Fakulteti i Filologjisë, Letërsi shqipe |
| Titulli i lëndës: | Letërsi popullore |
| Niveli: | bachelor |
| Statusi lëndës: | obligative |
| Viti i studimeve: | Viti I |
| Numri i orëve në javë: | 3+2 |
| Vlera në kredi – ECTS: | 6 |
| Koha / lokacioni: | Semestri dimëror, lokali i UGJ |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Dr.sc. Labinot Berisha |
| Detajet kontaktuese: | labi_b@yahoo.com |
| Përshkrimi i lëndës | |
| Përshkrimi i lëndës | Studentët do të kenë mundësi të mësojnë për veçantitë e letërsisë në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë për letërsinë popullore, për llojet e saj kryesore dhe për mënyrën e lindjes e të bartjes (transmetimit) prej një individi tek tjetri dhe prej një brezi në tjetrin. Sidomos do të mësojnë për mënyrën e shtjellimit të llojeve letrare dhe të mundësisë së ndikimit të tyre në dëgjuesin. Këto njohuri studentët do t'i fitojnë e do t'i thellojnë nëpërmjet ligjëratave, diskutimeve, detyrave të kursit, të punimeve seminarike. |
| Qëllimet e lëndës: | Qëllimi kryesor është që studentët të njihen me natyrën e letërsisë popullore, me llojet e ndryshme në poezi dhe në prozë si dhe llojet e ashtuquajtura të thjeshta (të shkurtra), të njohjes së mënyrës së të shprehurit poetik, sidomos të përdorimit të figurave të ndryshme letrare poetike, që e bëjnë të veçantë çdo tekst letrar. Po ashtu studentët do të mësojnë për elementet e përbashkëta dhe të ndryshme që i cilësojnë llojet e letërsisë popullore, qofshin ato në poezi ose në prozë. |
| Rezultatet e pritura të nxënies: | Të fitojnë njohuritë përkatëse që u përgjigjen aftësive të studentëve dhe mundësojnë që njohuritë e fituara të mund t'i zbatojnë në veprimet konkrete, qoftë gjatë procesit të mësimin ose gjatë provimeve që do t'u nënshtrohen më vonë. Të bëjnë ndryshimin midis llojeve letrare në dy gjinitë kryesore: poezi e prozë, por dhe t'i theksojnë ndryshimet brenda llojeve që i përkasin vetëm poezisë ose vetëm prozës. Të mësojnë si lind dhe bartet (funksionon) një krijim i letërsisë popullore dhe rëndësinë e tij në marrësin. |

| | | | |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|-----------------------------------------------------------|
| | Të mund t'i veçojnë tiparet e të shprehurit poetik, të gjuhës poetike dhe të figurave të ndryshme që përdoren në llojet e ndryshme të kësaj letërsie. | | |
| Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit) | | | |
| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithsej |
| Ligjërata | 3 (135 min.) | 15 | 34 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | | | |
| Punë praktike | 1 (45 min.) | 15 | 11 |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 10 min. | 15 | 34 |
| Ushtrime në teren | | | |
| Kollokfiume,seminare | 5 | 1 | 5 |
| Detyra të shtëpisë | 30 min. | 15 | 15 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 3 | 15 | 45 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 2 | 15 | 30 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | 1 | 1 | 1 |
| Projektet,prezentimet ,etj | | | |
| Totali | | | 143,5 orë 143.5:25=5,75 6 ECTS |
| Metodologjia e mësimdhënies: | Organizohet përmes ligjëratave teorike dhe të interpretimit, ushtrimeve që organizohen në grupe, punës individuale, diskutimeve, detyrave dhe punimeve seminarike. | | |
| Metodat e vlerësimit: | Vlerësimi do të bëhet në bazë të angazhimit të studentit në ligjërata e në aktivitetet plotësuese, diskutime, punime seminarike, suksesit të treguar në teste vlerësuese dhe metoda të tjera të vlerësimit. | | |
| Literatura | | | |
| Literatura bazë: | <ul style="list-style-type: none"> - Alfred Uçi, <i>Mitologjia, Foklori, Letërsia</i>. Tiranë 1982. - Anton Nikë Berisha, <i>Qasje poetikës së letërsisë gojore shqipe</i>. Rilindja, Prishtinë 1998. - Arben Prendi, <i>Letërsi gojore shqiptare</i>. Shkodër 2009 – 2010. - <i>Çështje të folklorit shqiptar</i>. Vëllimet I – IV. Akademia e shkencave e RPS të Shqipërisë. Instituti i kulturës popullore. Tiranë 1982 – 1989. | | |

| | |
|---------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| | <ul style="list-style-type: none"> - Demush Shala, <i>Rreth këngëve kreshnike shqiptare</i>. Rilindja, Prishtinë 1985. - <i>Folklori shqiptar</i> (Tekste për universitetin). Universiteti shtetëror i Tiranës, Instituti i folklorit, Tiranë 1972. - Shaban Sinani, <i>Mitologji në eposin e kreshnikëve</i>. Studim monografik. Botimi i dytë, “Argeta - LMG”, Tiranë 2006. - Veis Sejko, <i>Mbi elementet e përbashkëta në epikën shqiptare – arbëreshe dhe serbokroate</i>. Bargjini, Tiranë 2002. |
| Literatura shtesë: | <ul style="list-style-type: none"> - Anton Berisha, <i>Çështje të letërsisë gojore</i>, Rilindja, Prishtinë, 1982. - <i>Folkloristikë. Koncepte moderne</i>. Përzgjedhi Përktheu Arbnora Dushi. “Dukagjini”, Pejë 2007. - Dr. Eqrem Çabej, <i>Studime gjuhësore V</i>. “Rilindja”, Prishtinë, 1975. - Myzafere Mustafës, <i>Përralla shqiptare. Poetika dhe mitikja</i>. Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 2002. |

Plani i dizajnuar i mësimi:

| Java | Ligjërata që do të zhvillohet |
|------------------------------|-------------------------------------------------------|
| <i>Java e parë:</i> | Të njohurit e programit të lëndës – syllabusit |
| <i>Java e dytë:</i> | Letërsia popullore dhe veçantitë e saj |
| <i>Java e tretë:</i> | Historiku i shkurtër i letërsisë popullore shqipe |
| <i>Java e katërt:</i> | Letërsia gojore dhe letërsia e shkruar |
| <i>Java e pestë:</i> | Llojet kryesore të letërsisë popullore |
| <i>Java e gjashtë:</i> | Teoritë e ndryshme të studimit të letërsisë popullore |
| <i>Java e shtatë:</i> | Rëndësia e variantitetit |
| <i>Java e tetë:</i> | Epika gojore shqiptare |
| <i>Java e nëntë:</i> | Eposi i kreshnikëve |
| <i>Java e dhjetë:</i> | Lirika gojore |
| <i>Java e njëmbëdhjetë:</i> | Këngët e dashurisë dhe këngët e dasmës |
| <i>Java e dymbëdhjetë:</i> | Proza gojore |
| <i>Java e trembëdhjetë:</i> | Llojet e shkurtra |
| <i>Java e katërbëdhjetë:</i> | Pasqyrë e poezisë popullore të arbëreshëve të Italisë |
| <i>Java e pesëmbëdhjetë:</i> | Rishqyrtimi dhe përsëritja e programit të realizuar |

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Zhvillimi i mirëkuptimit reciprok, i ndjenjës së bashkëpunimit dhe të tolerimit, pjesëmarrja aktive në shqyrtimin e problemeve të studentëve dhe zgjidhja me kohë e tyre.

